



## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 20.10.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.10.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Geo-TECH" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizim me instrument GPS** ", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Geo-TECH" SH.P.K. e dt.18.10.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizim me instrument GPS** ", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 13.10.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 13.10.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

### A r s y e t i m

Me dt.18.10.2023, Operatori Ekonomik "Geo-TECH" SH.P.K ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "**Furnizim me instrument GPS** ", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 20.10.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj nuk qëndron , sepse Autoriteti Kontraktues, ka vendosur sipas kërkesave të FDT-së, specifikimeve teknike dhe vendimeve të OSHP-së.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj  
për: *[Signature]*  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës